

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve
të Kosovës
Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
(zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test

07.11.2021

Problemi 1

ABC SHPK është një shitës me pakicë, i specializuar për tregtimin e vitaminave, barnave që shiten pa recetë dhe ushqimeve të shëndetshme të cilat pretendohet se rrisin energjinë. Një nga produktet që ABC SHPK blen për të rishitur është një pije vitaminike që rrit performancën me emrin 'ELK'.

ABC SHPK shet një sasi fikse prej 200 shishesh të ELK çdo javë. Kostot e vlerësuara të ruajtjes dhe mbajtjes në depo për një shishe ELK janë € 2.00 në vit për shishe.

Shpërndarja nga furnitori ekzistues i ABC SHPK merr dy javë dhe çmimi i blerjes për shishe të marrë në dorëzim është € 20. Furnitori aktual ngarkon një shpenzim fiks për secilën porosi [mandat - blerje] me vlerë € 75 për porosi, pavarësisht prej madhësisë së porosisë [mandat - blerjes].

Pak ditë më patë ABC SHPK i është afruar një tjetër furnitor i ELK me ofertën e mëposhtme:

- 1 Kostoja e mallit për ABC SHPK do të jetë € 19 për shishe.
- 2 Kostoja fikse e përmbushjes së porosisë [mandat - blerjes] do të jetë € 250 pavarësisht prej madhësisë së porosisë në fjalë.
- 3 Secila porosi [mandat - blerje] do të përmbushet për një javë.
- 4 ABC SHPK vlerëson se për shkak të paketimeve të ndryshme, kostot e ruajtjes dhe deponimit për shishe do të jenë € 1.80 në vit për shishe.

Vini re

Sasia e porosisë ekonomike Q , e cila do të minimizojë kostot, është:

$$Q = \sqrt{\frac{2C_0D}{Ch}}$$

- Ku C_0 = Kostoja e dhënies së një porosie [mandat - blerje]
 D = Kërkesa vjetore
 Ch = Kostot e ruajtjes dhe deponimit për njësi për një vit

Kërkohet

- (a) Duke supozuar se ABC SHPK vazhdon të blejë prej furnitorëve ekzistues, llogaritni:
- (i) Sasinë e porosisë ekonomike
 - (ii) Nivelin e ri - porositjes
 - (iii) Kostot totale të ruajtjes dhe deponimit të ELK për një vit deri në € më të afërt (8 pikë)
- (b) (i) Llogaritni sasinë e porosisë ekonomike në qoftë se ABC SHPK ndryshon furnitorin dhe përcaktoni faktin nëse ndryshimi i furnitorit në fjalë do të ishte diçka ekonomike. (5 pikë)
- (ii) Diskutoni DY kufizimet e llogaritjeve të mësipërme dhe përshkruani shkurtimisht TRE faktorë të tjerë jo- financiarë të cilët duhet të mbahen parasysh para se të merret një vendim përfundimtar. (6 pikë)
- (c) Shpjegoni se çfarë nënkuptohet me termin Thjeshtë - në - Kohë (Just - in - Time) (TNK / JIT) dhe përshkruani shkurtimisht KATËR nga karakteristikat e tij kryesore. (6 pikë)
(Totali = 25 pikë)

Problemi 1 – Zgjidhja

- (a) (i) Duke përdorur modelin e sasisë së porosisë ekonomike:

$$Q = \sqrt{\frac{2C_0D}{C_h}}$$

- ku: C_0 = kosto për të bërë një porosi = €75
 D = kërkesa vjetore = $200 \times 52 = 10,400$
 C_h = kosto vjetore e mbajtjes për njësi = €2

$$Q = \sqrt{\frac{(2 \times \$75 \times 10,400)}{\$2}}$$

$$Q = \sqrt{780,000}$$

$$Q = 883.2 \text{ njësi}$$

Sasia e porosisë ekonomike është 883 njësi (në njësinë më të afërt).

- (ii) Kërkesa është fikse për 200 shishe për javë, dhe furnizimi nga furnitori merr dy javë. ABC SHPK duhet të ripozosisë kur rezervat e stoqeve bien në 400 njësi (kërkesa 2 javore).
 (iii) Kosto totale e Deponimit Bozë për një vit do të jenë:

	€
<i>Kosto e blerjes</i>	
10,400 njësi €20 secila	208,000
<i>Kostoe porosisë</i>	
Kërkesa vjetore (njësi) 10,400	
Madhësia e porosisë (njësi) 883	
Numri i porosive në vit 11.78	
Kosto e një porosie €75	
Kosto vjetore e porosive	883
<i>Kosto e mbajtjes</i>	
Stoqet mesatare (883/2) 441.5	
Kosto e mbajtjes për njësi €2	
Kosto vjetore e mbajtjes	883
Totali i koston vjetore	<u>209,766</u>

- (b) (i) Faktorët për furnitorin e ri janë si mëposhtë:

$$C_0 = €250$$

$$D = 10,400$$

$$C_h = €1.80$$

$$Q = \sqrt{\frac{(2 \times \$250 \times 10,400)}{\$1.80}}$$

$$= 1,699.7$$

Sasia e porosisë ekonomike është 1,700 njësi (në njësinë më të afërt).

Për të përcaktuar nëse është financiarisht e duhur të ndryshohet furnitori, ne duhet të kalkulojmë koston totale vjetore të porosive nga furnitori dhe ta krahasojmë me koston ekzistuese vjetore.

	€
<i>Kosto e blerjes</i>	
10,400 njësi €19 secila	197,600
<i>Kosto e porosisë</i>	
Kërkesa vjetore (njësi)	10,400
Madhësia e porosisë (njësi)	1,700
Numri i porosive në vit	6.12
Kosto për një porosi	€250
Kosto vjetore e porosive	1,530
<i>Kosto e mbajtjes</i>	
Stoqet mesatare (1,700/2)	850
Kosto e mbajtjes për njësi	€1.80
Kosto vjetore e mbajtjes për njësi	1,530
Totali i kostove vjetore	<u>200,660</u>

Kjo është €9,106 më pak se sa kostot vjetore ekzistuese të blerjes, andaj do të jetë vendim i duhur të ndërrohen furnitorët.

(ii) Kufizimet e kalkulimeve përfshijnë të mëposhtmet:

- (1) **Kërkesa supozohet të jetë e njëjtë** përgjatë tërë vitit. Në praktikë, ka gjasë të paraqiten variacione.
- (2) **Supozohet që koha e udhëheqjes është konstante** dhe se furnizuesit janë tërësisht të besueshëm.
- (3) **Supozohet që kostot e blerjes janë konstante.** Në praktikë është e nevojshme të lejohen ndikimet e politikave të zbritjes së ndryshueshme dhe atyre të kredive.

Faktorët jofinanciar që duhet të shqyrtohen përfshijnë:

- (1) **Cilësia** duhet të jetë e përputhshme dhe e besueshme nga të dy furnizuesit.
- (2) **Dallimet në paketim** duhet të jenë të pranueshme dhe prodhimi nga furnizuesit duhet të jetë atraktiv në mënyrë të barabartë për klientët.
- (3) **Fleksibiliteti.** Të dy furnizuesit duhet të jenë në gjendje të reagojnë shpejtë dhe me efikasitet ndaj variacioneve në nivel të kërkesës.
- (4) **Ndikimet mjedisore.** ABC SHPK duhet të sigurohet që objektet e prodhimit plotësojnë standardet e dakorduara mjedisore të cilat I kërkon kompania.

(c) **Prodhimi pikërisht në kohë (PNK)** përfshin sigurimin e mallrave nga furnizuesit në kohën më të fundit të mundshme (d.t.th. kur ato janë të nevojshme për linjën e prodhimit), duke shmangur kërshu nevojën për bartjen e ndonjë materiali ose inventari të komponentëve. Nivelet e reduktuara nënkuptojnë që do të jetë I nevojshëm një nivel më i ulët i investimeve në kapitalin e punës. Në mjedis të caktuar ku kostoja e kostove të shitjeve është e lartë, PNK është e papërshtatshme, p.sh. në spital, kostoja e kostove të shitjes për artikuj të caktuar mund të jetë fatale.

Veçoritë kryesore të sistemit të PNK-së përfshijnë të mëposhtmet:

- (i) **Dërgesat** do të jenë të vogla dhe të mesme, në vend se të jenë në grumbuj. **Prodhimet** gjithashtu do të jenë më të shkurta.
- (ii) **Raportet me furnizuesit** duhet të jenë të ngushta, meqë do të ketë kërkesa të mëdha ndaj furnizuesve për të bërë dërgesa me kohë dhe me cilësi 100%.
- (iii) **Çmimet e blerjes për njësi** ndoshta duhet të jetë më e lartë sesa në sistemin konvencional për kompensimin e furnizuesve për nevojën e tyre për të mbajtur inventarë më të lartë dhe për të përmbushur një cilësi më rigorozë dhe kërkesa të dërgesës. Sidoqoftë, kursimet në kostot e prodhimit dhe reduktimet në kapitalin e punës duhet të zëvendësojnë këto kosto.
- (iv) **Produktiviteti i përmirësuar i punës** duhet të rezultojë nga një qarkullim më i lehtë i materialeve nëpërmjet procesit.

(v) **Përmirësimet e procesit të prodhimit mund të kërkohen ashtu që një system PNK të mund të funksionojë me efektshmëri të plotë. Në veçanti mund të ketë nevojë që të reduktohet koha për vendosjen e makinerisë, të riorganizohen ekipet e fuqisë punëtore dhe të minimizohet zhvendosja e materialeve të procesit të prodhimit.**

Problemi 2

Drejtorët e ABC, një konglomerat i madh, janë duke shqyrtuar përfitimën [blerjen] e të gjithë kapitalit aksionar të Manon, i cili prodhon një gamë të gjerë makinerish inxhinierike. Asnjë nga kompanitë nuk ka kapital afat - gjatë të huazuar. Drejtorët e ABC besojnë se edhe po qe se përftohet [blijet] Manon, rreziku i biznesit të ABC do të mbetet njësoj.

Data e referimit kontabël të Manon - it është 31 Korrik. Bilanci i gjendjes të Manon - it në datën 31 Korrik 20X4 pritet të jetë si më poshtë.

	€	€
Pasuritë jo - qarkulluese (neto nga zhvlerësimi)		651,600
Pasuritë qarkulluese: Stoqet dhe puna në progres	515,900	
Të farkëtueshmet	745,000	
Tepricat në bankë	<u>158,100</u>	
		<u>1,419,000</u>
		<u>2,070,600</u>
Detyrimet afat - shkurtra: Të pagueshmet	753,600	
Mbitërheqja bankare	<u>862,900</u>	
		1,616,500
Kapitali dhe rezervat:		
Aksionet e zakonshme të emetuara me vlerë € 1 secila		50,000
Rezervat e shpërndashme		<u>404,100</u>
		<u>2,070,600</u>

Regjistrat e përmbledhur financiarë të Manon- it për pesë vitet që mbarojnë në 31 Korrik 20X4 janë si më poshtë.

<i>Vitin që mbaron në 31 Korrik</i>	<i>20X0</i>	<i>20X1</i>	<i>20X2</i>	<i>20X3</i>	<i>20X4</i> (të vlerësuara)
	€	€	€	€	€
Fitimi para ngjarjeve që nuk ndodhin më	30,400	69,000	49,400	48,200	53,200
Ngjarje që nuk ndodhin më	<u>2,900</u>	<u>(2,200)</u>	<u>(6,100)</u>	<u>(9,800)</u>	<u>(1,000)</u>
Fitimi pas ngjarjeve që nuk ndodhin më	33,300	66,800	43,300	38,400	52,200
Minus dividendët	<u>20,500</u>	<u>22,600</u>	<u>25,000</u>	<u>25,000</u>	<u>25,000</u>
I shtohen rezervave	<u>12,800</u>	<u>44,200</u>	<u>18,300</u>	<u>13,400</u>	<u>27,200</u>

Njëkohësisht janë në dispozicion informacionet e mëposhtme financiare.

- (1) Nuk ka pasur ndryshime në kapitalin e emetuar aksionar të Manon - it gjatë pesë vjetëve të kaluara.

- (2) Vlerat e vlerësuar të pasurive jo - qarkulluese dhe stoqeve dhe punës në progres të Manon - it të datës 31 Korrik 20X4 janë si më poshtë.

	<i>Kostoja e zëvendësimit</i>	<i>Vlera e realizueshme</i>
	€	€
Pasuritë jo - qarkulluese	725,000	450,000
Stoqet dhe puna në progres	550,000	570,000

- (3) Pritet që 2% të të arkëtueshmeve të Manon - it në datën 31 Korrik 20X4 të jenë të pa - arkëtueshme.
- (4) Kostoja e kapitalit të ABC është 9%. Drejtorët e Manon - it vlerësojnë se aksionarët e Manon - it kërkojnë një normë minimale të kthimit prej 12% në vit nga investimi i tyre në kompani.
- (5) Koeficienti aktual çmim / fitim (P/E) i ABC është 12. Kompani të tjera të regjistruara në bursë me aktivitete biznesi dhe fitim - prurje të ngjashme me atë të Manon - it kanë koeficientë aktualë çmim / fitim (P/E) të barabartë me 10, megjithëse këto kompani janë në përgjithësi shumë më të mëdha se sa Manon.

Kërkesat:

- (a) Vlerësoni vlerën e ekuitetit total të Manon - in në datën 31 Korrik 20X4 duke përdorur secilën nga bazat e mëposhtme:
- (i) Vlerat e bilancit të gjendjes;
 - (ii) Kostoja e zëvendësimit të pasurisë;
 - (iii) Vlera e realizueshme e pasurisë;
 - (iv) Modeli i vlerësimit të dividendëve;
 - (v) Modeli i koeficientit çmim / fitime (P / E). (13 pikë)
- (b) Shpjegoni rolin dhe kufizimet e secilës nga pesë bazat e vlerësimit më sipër në procesin sipas të cilit bihet dakord për çmimin e blerjes së të gjithë kapitalit ekuitar të Manon - it nga ABC. (6 pikë)
- (c) Parashtroni dhe justifikoni shkurtimisht intervalin brenda të cilit ka gjasa të dakordohet çmimi i blerjes. (6 pikë)
- Mos mbani parasysh tatimet. (Totali = 25 pikë)

Problemi 2 – Zgjidhja

- (a) (i) Vlera e bilancit të gjendjes = €454,100.
- (ii) Vlera e kostos së zëvendësimit = €454,100 + €(725,000 - 651,600) + €(550,000 - 515,900) = €561,600.
- (iii) Vlera e realizueshme = €454,100 + €(450,000 - 651,600) + (570,000-515,900)-€14,900 = €291,700.

Borxhet e këqija janë $2\% \times €745,000 = €14,900$. Borxhet e këqija supozohen të mos jenë relevante për fletën e bilancit dhe vlerat e kostos së zëvendësimit.

- (iv) Modeli i rritjes së dividendës varet nga një llogaritje e përafërt e rritjes, i cili është larg nga të qenit i qartë për shkak të variacioneve të gjera në fitime mbi pesë vite.

- 1 Vlera më e ulët e mundshme, që supozon një rritje prej zero, është si në vijim:

$$\text{Vlera cum div} = \frac{\$25,000}{0.12} + \$25,000 = \$233,333$$

Nuk ka gjasë që kjo të jetë baza e marrë.

- 2 Duke shikuar rritjen e dividendës përtej pesë viteve të kaluara fitojmë:

$$\text{Dividenda } 20X4 = €25,000$$

$$\text{Dividenda } 20X0 = €20,500.$$

Nëse norma vjetore e rritjes së dividendës është g

$$(1 + g)^4 = \frac{(25,000)}{20,500} = 1.2195$$

$$1 + g = 1.0508$$

$$g = 0.0508, \text{ le të themi } 5\%$$

$$\text{Pastaj, MV cum div} = \frac{\text{Dividendi 1 year}}{0.12 - g} + \text{currentdiv}$$

$$= \frac{25,000(1.05)}{0.07} + \$25,000$$

$$= €400,000.$$

- 3 Duke përdorur modelin rb, fitojmë :

Proporcioni mestar i mbajtur =

$$\frac{12,800 + 44,200 + 18,300 + 13,400 + 27,000}{33,300 + 66,800 + 43,300 + 38,400 + 52,200} = 0.495 \text{ (say } b = 0.5)$$

$$\begin{aligned} \text{Kthimi nga investimet këtë vit} &= \frac{53,200}{\text{average investment}} \\ &= \frac{53,200}{(454,100 + (454,100 - 27,200))} \end{aligned}$$

$$= 0.1208 \text{ (say } r = 12\%).$$

$$\text{Pastaj } g = 0.5 \times 12\% = 6\%$$

$$\text{so MV cum div} = \frac{\$25,000(1.06)}{0.06} + \$25,000 = \$466,667$$

(v) Modeli i proporcionit P/E

Kompanitë e kuotuar të krahasueshme tek Manon kanë proporcione P/E prej rreth 10. Mamon është shumë më i vogël dhe duke qenë i kuotuar proporcioni i tij P/E do të ishte më i vogël se 10, por sa më i vogël?

Nëse marrim proporcionin P/E prej 5, fitojmë MV = €53,200 × 5 = €266,000.

Nëse marrim proporcionin P/E prej 10 × 2/3, fitojmë MV = €53,200 × 10 × 2/3 = €354,667.

Nëse marrim proporcionin P/E prej 10, fitojmë MV = €532,000.

(b) (i) Vlera e fletës së bilancit

Vlera e fletës së bilancit nuk duhet të luajë një rol në procesin e negociatave. Kostoja historike nuk është relevante për ndonjë vendim rreth vlerës së ardhshme të kompanisë.

(ii) Kostoja e zëvendësimit

Kjo cakton koston e krijimit të një biznesi të ngjashëm. Meqë kjo jep një shifër më të lartë se sa ndonjë vlerësim tjetër në këtë rast, ai do të mund të tregonte çmimin maksimal që duhet të ofrohet tek ABC.

(iii) Vlera e realizueshme

Kjo tregon paratë e gatshme të cilat aksionari në Manon do të mund t'i siguronte duke likuiduar biznesin. Prandaj ai është çmimi minimal të cilin ata do të mund ta pranonin.

Të gjitha metodat (i) deri në (iii) vuajnë nga kufizimi të cilin ata nuk e shikojnë lidhurme vlerën e vijueshmërisë të biznesit si tërësi. Metodat (iv) dhe (v) e konsiderojnë këtë vlerë. Sidoqoftë, vlera e realizueshme është përdoruese gjatë vlerësimit të rrezikut të bashkëngjitur tek biznesi si vazhdimësi, meqë jep vlerën bazë nëse gjërat nuk shkojnë si duhet dhe biznesi duhet të braktiset.

(iv) Modeli i dividendës

Shifrat janë kalkuluar duke përdorur K_e (12%) e Manonit. Nëse (2) ose (3) do të ishin përcjellë, vlera do të ishte minimumi të cilin do ta pranonin aksionarët e Manonit, derisa vlera në përdorim tejkalon vlerën e mbetur në (iii). Relevanca e vlerësimit të dividendës për ABC do të varet nga ajo nëse mbajtja momentale dhe politikat e investimit të sërishëm do të vazhdoheshin. Sigurisht vlera e Karmenit duhet të bazohet në 9% në vend të 12%. Të dyja kompanitë janë futur dhe në të njëjtën klasë të rrezikut ashtu që kthime të ndryshme të kërkuara mund të jenë të nevojshme për shkak të madhësive të tyre relative dhe faktit që aksionet e Karmenit janë më të tregtueshme.

Njëra prej kufizimeve kryesore të modelit të rritjes së dividendës është problemi i llogaritjes së vlerës së ardhshme të g.

(v) Modeli P/E

Modeli i proporcionit P/E është një përpjekje për të arritur në vlerën të cilën tregu do t'ia impononte kompanisë si Manon. Nuk ofron kut të jashtëm, por është një masë shumë e ashpër. Siç u cek më herët, propocioni P/E i cili aplikohet për kompanitë e mëdha të kuotuar duhet të ulet për të mundësuar madhësinë e Manonit dhe jotregtueshmërinë e aksioneve të saj. Një kufizim tjetër i proporcioneve P/E është se propocioni varet shumë prej rritjes së ardhshme të pritshme të firmës. Prandaj nuk është lehtë të gjendet një propocion P/E i ndonjë firme të ngjashme. Sidoqoftë, në praktikë modeli P/E mund të përmbahet si duhet në negocita rreth çmimit, thjeshtë për shkak se paraqet një kut lehtë të kuptueshëm.

- (c) Fushëveprimi brenda së cilës çmimi i blerjes ka gjasë të jetë i akordueshëm do të jetë çmimi minimal të cilën aksionarët e Manonit do të pranojnë dhe çmimi maksimal të cilin drejtorët e ABC do të paguajnë.

Ekzaminimi i shifrave në pjesën (a), fushëveprimi është €291,700 (vlera e realizueshme) deri €561,600 (kosotja e zëvendësimit).

Problemi 3

Kompania ABC është duke marrë parasysh pranimin e porosisë nga konsumatori kryesor i saj për prodhimin e një komponenti të veçantë të pajisjeve për shpime. Për këtë qëllim, menaxhmenti i Kompanisë ABC është duke hulumtuar mundësitë e blerjes së një makinë të posaçme. Përzgjedhja është ngushtuar në dy modele. Informacionet e mëposhtme janë mbledhur për çdo model:

Modeli A - Kostoja e blerjes €250,000
Jeta e përdorimit 3 vjet
Shpenzimet vjetore operative €35,000

Modeli B - Kostoja e blerjes €165,000
Jeta e përdorimit 2 vjet
Shpenzimet vjetore operative €55,000

Kostoja e kapitalit e kompanisë ABC është 10%

Kërkohet:

- a. Të llogaritet VNT për secilin makinë dhe mbi këtë bazë të sugjerohet vendimmarrja. (13 pikë)
- b. Duke supozuar se kompania ABC do të furnizoi në vazhdimësi konsumatorin e saj për 6 vjet me radhë, të përcaktohet se cila makinë duhet të blihen. (12 pikë)

Shënim: Duhet të merren parasysh kohëzgjatjet e ndryshme të jetës së përdorimit të makinave.

(Totali: 25 pikë)

Problemi 3 – Zgjidhja

a. VNT – Modeli A

<u>Vitet</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Rrjedhja e parasë</u>	<u>Faktori skontues</u>	<u>Vlera e tanishme</u>
0	Kostoja e blerjes	€250,000	1.0000	€250,000
	Shpenzimet			
1-3	vjetore operative	€35,000	2.4869	<u>€87,040</u>
			Total:	<u>€337,040</u>

VNT – Modeli B

<u>Vitet</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Rrjedhja e parasë</u>	<u>Faktori skontues</u>	<u>Vlera e tanishme</u>
0	Kostoja e blerjes	€165,000	1.0000	€165,000
	Shpenzimet			
1-2	vjetore operative	€55,000	1.7355	<u>€95,455</u>
			Total:	<u>€260,455</u>

Bazuar në kalkulimet e VNT Modeli B duhet të zgjedhet sepse ka VNT të shpenzimeve më të vogël.

b. VNT – Modeli A

<u>Vitet</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Rrjedhja e parasë</u>	<u>Faktori skontues</u>	<u>Vlera e tanishme</u>
0	Kostoja e blerjes	€250,000	1.0000	€250,000
	Shpenzimet			
1-3	vjetore operative	€35,000	2.4869	€87,040
3	Kostoja e blerjes	€250,000	0.7513	€187,829
	Shpenzimet			
4-6	vjetore operative	€35,000	1.8684	<u>€65,394</u>
			Total:	<u>€590,263</u>

VNT – Modeli B

<u>Vitet</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Rrjedhja e parasë</u>	<u>Faktori skontues</u>	<u>Vlera e tanishme</u>
0	Kostoja e blerjes	€165,000	1.0000	€165,000
	Shpenzimet vjetore operative			
1-2		€55,000	1.7355	€95,455
2	Kostoja e blerjes	€165,000	0.8264	136,364
	Shpenzimet vjetore operative			
3-4		€55,000	1.4343	78,888
4	Kostoja e blerjes	€165,000	0.6830	112,697
	Shpenzimet vjetore operative			
5-6		€55,000	1.1854	<u>65,197</u>
			Total:	<u>653,600</u>

Modeli A duhet të blihet për shkak të kostos më të ultë.

Problemi 4

ABC sh.p.k. është një kompani Irlandeze e cila merret me publikimin e librave shkollor në disa gjuhë. Klientët e ABC-së janë nga e gjithë bota dhe gjatë pesë vjeçarit të fundit ka zhvilluar departamente të shërbimit ndaj klientëve në këto vende:

- Perth, Western Australi
- Capetown, Afrikë
- Mumbai, India
- Dusseldorf, Gjermani
- Bangkok, Tailandë

Menaxhmenti i ABC-së janë të pajtimit që rritja e madhe e kompanisë gjatë pesë viteve të fundit ka qenë kryesisht si rezultat i mbështetjes lokale të klientëve në këto pesë lokacione. Kompania planifikon të hapë edhe pesë qendra të reja gjatë dy viteve të ardhshme.

ABC ka bërë marrëveshje me kreditorët e saj për një afat kohor të pagesës prej 14-ditës. Gjysmës së klientëve i ofron 15 ditë shitje me kredi, ndërsa pjesës tjetër i ofrohen 30 ditë afat pagese. Stoku rezervë i librave shkollor nuk duhet të mbahen më shumë se për një javë.

Menaxheri bankar i ABC-së kohëve të fundit ka theksuar që nëse kompania e shfrytëzon limitin maksimal të mbitërheqjes bankare prej €300,000, nuk do të ketë mundësi për rritje të saj. Ekstrakti nga pasqyrat financiare më të fundit të ABC-së janë prezantuar si në vijim:

ABC		
Pasqyra e pozitës financiare më 31 Korrik 2021		
	2020	2021
	€000s	€000s
Pasuritë afatgjata		
Patundshmëritë dhe impiantet	300	3,600
Pasuritë tjera	<u>60</u>	<u>780</u>
Totali	360	4,380
Pasuritë afatshkurtra		
Stoqet	40	760
Të arkëtueshmet tregtare	60	1,820
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	190	0
Totali	<u>290</u>	<u>2,580</u>
Totali i pasurive	650	6,960
Kapitali dhe Detyrimet	<u> </u>	<u> </u>
Kapitali aksionar		
Aksionet e zakonshme (@ €2/aksion)	50	50

Rezervat tjera	<u>510</u>	<u>4,560</u>
	<u>560</u>	<u>4,610</u>
Detyrimet afatgjata		
Huazimet afatgjata	0	360
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet tregtare	40	1,040
Dividenda e pagueshme	50	500
Huazimet afatshkurtra	0	290
Pjesa afatshkurtër e huazimeve afatgjata	<u>0</u>	<u>160</u>
Totali	<u>90</u>	<u>1,990</u>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	650	<u><u>6,960</u></u>

ABC
Pasqyra e të ardhurave - 31 Korrik 2021

	2020	2021
	€000s	€000s
Të hyrat	1,700	14,400
KMSH	1,400	<u>10,400</u>
Fitimi bruto	<u>300</u>	4,000
Minus: Shpenzimet	200	3,100
Fitimi neto	<u>100</u>	<u>900</u>

Kërkohet:

Përgatisni një raport për menaxhmentin e ABC-së ku duhet prezantuar performancën financiare të kompanisë përgjatë vitit të kaluar dhe vlerësoni pozitën financiare të kompanisë më 31 korrik 2012.

(Totali = 25 pikë)

Problemi 4 – Zgjidhja

Solvenca

Kjo i referohet aftësisë së ABC për ti kryer të gjitha pagesat afatshkurtra në afat.

Likuiditeti	2010	2011
Koeficientin rrjedhës	3.22	1.30
Koeficienti i shpejtë	0.56	0.93

Paraja në dorë

Rezervat e parasë së gatshme janë reduktuar nga një tepricë prej €190,000 në vitin 2010, në një mbitërheqje bankare prej €290,000 më 31 korrik 2011. Kjo është mjaft afër limitit të mbitërheqjes bankare i cili është €300,000 dhe i cili nuk pritet të ketë rritje të mundshme.

Koeficienti rrjedhës

Koeficienti rrjedhës (pasuritë afatshkurtra : detyrimet afatshkurtra) është një test standard i likuiditetit. Ky koeficient është përkeqësuar nga 3.22 në 2010 në 1.3 në vitin 2011. Kjo përfaqëson një përkeqësim të pozitës likuide dhe bie nën vlerën e pranueshme që zakonisht duhet të jetë mbi 1.

Koeficienti i shpejtë

Ky koeficient paraqet një test më rigoroz të likuiditetit duhet përjashtuar stoqet gjatë vlerësimit të aftësisë për kryerjen e obligimeve afatshkurtra. Ky koeficient është përmirësuar nga 0.56 në 2010 në 0.93 në vitin 2011. Edhe pse është një përmirësim i konsiderueshme, prapë se prapë është nën mesataren e rekomanduar prej 1:1. Në përgjithësi, kompania është në rrezik të mbi-tregtimit, pasi që po tenton të mbështesë investimet në pasuri afatgjata dhe afatshkurtra me financim jo të mjaftueshëm. Simptomat e mbi-tregtimit të ABC-së janë:

- Rritje e shpejtë në qarkullim (shitje);
- Rritje e shpejtë në nivelin e mbajtës së stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme;
- Përkeqësim i balancave të parasë së gatshme;
- Përkeqëson i koeficientit rrjedhës;

Mbi-tregtimi shpie në probleme të pashmangshme të likuiditetit. Për ta mënjeluar këtë problem të insolvencës ABC duhet të përcaktoj nevojat për rrjedhje të vazhdueshme të parasë (kapitali punues dhe investimet afatgjata) përgjatë një periudhe afatmesme (1-5 vite) dhe të ketë një financim afatmesëm/afatgjatë për ti realizuar këto nevoja.

Cikli i kapitalit punues

Cikli i kapitalit punues të një kompanie matë në ditë mesataren e kohës që paraja është e bllokuar në kapital qarkullues. Cikli i ABC-së është përkeqësuar pasi që është rritur nga 23 ditë në 36 ditë gjatë pesë viteve. Detajet janë prezantuar si në vijim:

Përlllogaritja e ciklit operativ (ditët)

	2010	2011
	Ditët	Ditët
Ditët në stoqe	10	27
Ditët në LL/A	13	46
Ditët në LL/P	-10	-37
Cikli operativ	13	36

Një shqetësim i lartë është se stoqet mbahen për 20 ditë sesa që pritet (1 javë), përderisa debitorët (klientët) marrin kohë 24 ditë më shumë (mesatare) për të kryer pagesat e tyre ndaj ABC-së. Kontrolli i stokut dhe

kreditorëve (LL/P) duhet të rishikohet për të përcaktuar pse paraja e gatshme e ABC-së është e bllokuar më shumë sesa që është planifikuar. Përderisa rritja prej 27 ditëve në LL/P mund të duket si përmirësim, duhet të theksohet që koha mesatare e pagesës është shumë larg termeve të dakorduara me kreditorët. Kjo mund të ketë ndikim negativ në rejtingun kreditor, pasi që ai mund të dëmtohet nëse trendët vazhdojnë si të tilla.

Performanca operative

Kompania ka pasur një rritje impresionuese në qarkullim prej 8.5 herë të shifrës së shitjeve në 2010 në pesë vite. ROCE mbetet e lartë prej 13%, sidoqoftë 2% më pak se në 2010. Kjo është për arsye se shpenzimet janë rritur në disproporcion në pesë vitet e fundit pasi që përmirësimi i marzhës bruto prej 10% është zbehur tërësisht kur marrim në konsideratë që marzha neto ka mbetur statike përgjatë 5 viteve.

Indikatorët e performancës	2010	2011
Marzha bruto	18%	28%
Marzha neto	6%	6%
ROCE	15%	13%

Përfundim

Përkeqësimi i likuiditetit përgjatë pesë viteve është si rezultat i mbi-tregtimit, menaxhimit të dobët të kapitalit qarkullues dhe rritjes së bazës së shpenzimeve si rezultat i zgjerimit të operacioneve. Kjo mund të përmirësohet duke: (i) marrjes së financimit afatgjatë për të financuar rritjen e kompanisë dhe pozitën e mbi-tregtimit; (2) menaxhuar shpenzimet më mirë; (3) menaxhuar kapitalin qarkullues më mirë;